



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË - DEGA E GJYKATËS VUSHTRRI

Numri i lëndës: 2019:241392

Datë: 20.12.2024

Numri i dokumentit: 06630466

C.nr.535/19

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË-DEGA NË VUSHTRRI, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil, me gjyqtarin Jeton Zymeri në çështjen juridike kontestimore të paditësit A.S nga fshati ...-Komuna e Vushtrrisë, të cilin e përfaqëson sipas autorizimit N.M avokat nga Prishtina, rruga "...", nr..., kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve "...", me seli në Prishtinë, rruga "... OB-..., .., të cilën me autorizim e përfaqëson V.V, me objekt kontesti kompensim i dëmit material dhe jo material, me vlerë të kontestit 5,484.00 euro, pas përfundimit të shqyrtimit kryesor e publik, të mbajtur me datë 09.12.2024, në prezencë të përfaqësuesit të paditësit dhe përfaqësueses së të paditurës, me datë 20.12.2024 mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. APROVOHET pjesërisht si e bazuar kërkesëpadia e paditësit A.S nga fshati ...-Komuna e Vushtrrisë.

II. DETYROHET e paditura Kompania e Sigurimeve "...", me seli në Prishtinë, që për kontributin e dhënë nga i siguruari i saj në shkaktimin e aksidentit të komunikacionit të datës 03.06.2019, në fshatin ..., Komuna e Vushtrrisë, e rrjedhimisht për dëmin e shkaktuar nga ky aksident, paditësit A.S, t'ia paguaj shumat si vijon:

Në emër të dëmit material:

- për ndihmë dhe kujdes të huaj, shumën prej 140.00 €

- për ushqim të përforcuar, shumën prej 140.00 €

Gjithsejtë për dëmin material, shumën prej 280.00 € (dyqind e tetëdhjetë euro), me kamatë ligjore prej 8%, në vit, duke filluar nga paraqitja e padisë (23.07.2019) e deri në përmbushjen definitive, në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të aktgjykimit e nën kërcënim të përmbarimit të dhunshëm.

Në emër të dëmit jo material:

- për dhimbje fizike, shumën prej 1,000.00 €
- për frikën e pësuar, shumën prej 1,000.00 €

Gjithsejtë për dëmin jo material shumën prej 2,000.00 € (dymijë euro), me kamatë ligjore prej 8 %, në vit, duke filluar nga dita e nxjerrjes së aktgjykimit (20.12.2024) e deri në përmbushjen definitive, në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të aktgjykimit e nën kërcënim të përmbarimit të dhunshëm.

III. DEYROHET e paditura Kompania e Sigurimeve "...", me seli në Prishtinë, që paditësit t'ia paguaj shpenzimet e procedurës në shumën prej 714.00 € (shtatëqind e katërbëdhjetë euro), në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të aktgjykimit e nën kërcënim të përmbarimit të dhunshëm.

IV. REFUZOHET si e pabazuar pjesa tjetër e kërkesëpadisë së paditësit mbi shumat e gjykuara si në pikën II të dispozitivit, në shumën prej 3,050.00 € (tremijë e pesëdhjetë euro) dhe pjesa e kërkesëpadisë së paditësit për kompensimin e dëmit material-rehabilitim fizio-terapeutik në shumën prej 154.00 € (dyqind e dhjetë euro).

A r s y e t i m

Paditësi A.S nga fshati ...-Komuna e Vushtrrisë, përmes përfaqësuesit të tij, me datë 23.07.2019, ka parashtruar padi kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve "...", me seli në Prishtinë, rruga "... OB-..., ..., përmes së cilës ka kërkuar kompensimin e dëmit material dhe jo material, të shkaktuar nga i siguruari i të paditurës në aksidentin e komunikacionit të datës 03.06.2019. Me parashtruesën e datës 02.12.2024, ka precizuar-zmadhuar kërkesëpadinë duke kërkuar që të detyrohet e paditura që paditësit t'ia kompensojnë dëmin material dhe jo material dhe atë: në emër të dhimbjeve fizike shumën prej 3,000.00 euro, në emër të frikës shumën prej 2,000.00 euro, në emër të ndihmës së personit të tretë për shumën prej 225.00 euro, në emër të ushqimit të përforcuar shumën prej 105.00 euro si dhe në emër të rehabilitimit fiziatik shumën prej 154.00

euro, në total shumë prej 5,484.00 euro, me kamatë prej 8 %, duke filluar nga data e ushtrimit të padisë e deri në pagesën definitive.

Në fjalën përfundimtare i ka propozuar gjykatës që ta aprovojë kërkesëpadinë si të bazuar, në shumë si në precizim prej 5,484.00 euro, me kamatë prej 8%, duke filluar nga parashtrimi i padisë. Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar dhe atë për dy seanca gjyqësore nga 135.00 euro, totalin prej 270.00 euro, 104 euro për përpilimin e padisë, 104.00 euro për parashtesën për precizimin e padisë, 300.00 euro në emër të ekspertizës mjekësore, si dhe 40.00 euro në emër të taksës për padi, përkatësisht shumë totale prej 818.00 euro.

E paditura në përgjigje në padi nuk e ka kontestuar padinë në kuptim të përgjegjësisë për shkaktimin e aksidentit, por vetëm për nga lartësia, përfaqësuesit të paditësit i ka paraqitur ofertë për kompensimin e dëmit material dhe jo material në shumë prej 532.60 euro. Në fjalën përfundimtare ka theksuar se baza juridike e kërkesëpadisë nuk ka qenë asnjëherë kontestuese, por kontestuese është lartësia e precizuar e kërkesëpadisë, e cila është e të lartë dhe jo në harmoni me lëndimet e pësuar tek paditësi, pasi që në bazë të provave të prezantuara dhe pas nxjerrjes së ekspertizave mjekësore, është konstatuar se paditësi ka pësuar lëndime të lehta trupore, pa pasoja të përhershme, andaj lidhur me kërkesat në emër të dhimbjeve fizike dhe frikës së përjetuar, të njëjtat i ka kundërshtuar si shuma jashtëzakonisht të larta dhe jo në proporcion me lëndimet e pësuar, duke marr parasysh faktin se qëllimi kryesor është rehabilitimi shpirtëror i paditësit për shkak të lëndimeve trupore të pësuar dhe pasojave të shkaktuara. Po ashtu i ka kundërshtuar kërkesat në emër të ndihmës dhe kujdesit të huaj si dhe ushqimit të përforcuar, kjo bazuar në ekspertizën mjekësore dhe sipas praktikës së unifikuar, kompensimi për kërkesat që merren brenda për brenda familjes, se paditësit i takon kompensimi prej 5 deri në 7 euro për ditët e caktuara nga ekspertët. Kërkesën në emër të rehabilitimit klimaterik, po ashtu e ka kundërshtuar në mungesë të provave materiale dhe i ka propozuar gjykatës që të njëjtën ta refuzojë. Sa i përket shpenzimeve të procedurës, i ka kundërshtuar shpenzimet në emër të parashtresës për precizim të kërkesëpadisë, ndërsa lidhur me pjesën tjetër të shpenzimeve të procedurës, i ka propozojmë gjykatës që me rastin e vendosjes të ketë parasysh suksesin e paditësit në realizimin e kërkesëpadisë, ndërsa kërkesën me kamatë prej 8% nga dita e ushtrimit të padisë, të njëjtën e ka kundërshtuar, me arsyetimin se e paditura në procedurë administrative brenda afateve ligjore të LSDA-së, e ka trajtuar kërkesën dhe ka dalë me ofertë, andaj lidhur me këtë i ka propozuar gjykatës që të ketë parasysh vendosjen konfrom dispozitave ligjore të LMD-së si dhe Mendimit Juridik të Gjykatës Supreme lidhur me kamatën. Shpenzimet e procedurës nuk i ka kërkuar.

Gjykata për vlerësimin e drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike në këtë çështje juridike në procedurën e provave nga shqyrtimi i mbajtur në këtë gjykatë, bëri administrimin e provave me leximin e raportit policor nr.2019-BR-187 i datës 03.06.2019, së bashku me skicën e bashkangjitur, raportet mjekësore që gjenden në shkresat e lëndës, në bazë të të cilave është hartuar ekspertiza mjekësore e datës 15.11.2024, kërkesa për kompensim dëmi e datës 10.06.2019, njoftimi i datës 03.07.2019 dhe ekspertiza mjekësore e datës 15.11.2024, e hartuar nga Dr. S.S- ortoped dhe Dr. B.O-psikiatër.

Pasi që gjykata bëri vlerësimin e secilës provë veç e veç dhe të gjithave së bashku, mbështetur në dispozitat nga neni 8 i Ligjit për Procedurën Kontestimore, arriti në përfundimin se në këtë çështje juridike civile duhet vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, nga këto arsye.

Në mes të palëve ndërgjyqëse nuk ishte kontestuese baza e kërkesëpadisë meqë e autorizuara e palës së paditur asnjëherë nuk e ka kontestuar, madje palës paditëse i ka ofruar ofertë për arritjen e marrëveshjes.

Kontestuese ishte lartësia e kërkesëpadisë të precizuar me parashtresën e datës 02.12.2024. Për të vërtetuar lartësinë e kërkesëpadisë, gjykata sipas propozimit të autorizuarit të paditësit, në cilësinë e provës materiale, ka nxjerr ekspertizën mjekësore të punuar nga Dr. S.S ekspert i ortopedisë dhe B.O ekspert i psikiatrisë, të cilët në bazë të dokumentacionit mjekësor dhe pas ekzaminimit të drejtpërdrejt të paditësit, kanë dhënë mendimin profesional, përmes ekspertizës së punuar me shkrim datë 15.11.2024, ku sipas tyre paditësi A.S, në aksidentin e komunikacionit të datës 03.06.2019, ka pësuar përkyerje të qafës, ndrydhje të unazave lumbale dhe ndrydhje të regjionit radiokarpal të djathtë, (të cilësuara si lëndime të lehta trupore).

Me këto prova të administruara gjykata për paditësin A.S, në emër të dhimbjeve fizike aprovoi kërkesën në shumën prej 1.000.00 euro dhe e vlerësoi si një shpërblim të drejtë dhe që i shërben qëllimit të shpërblimit, sepse paditësi, sipas mendimit të ekspertit mjekësor ortoped si pasoj e lëndimeve të marra, ka pësuar dhimbje fizike të intensitetit të lartë dy ditë, dhimbje fizike të intensitetit të mesëm që ka zgjatur dy javë (14 ditë) dhe dhimbje fizike të intensitetit të ulët që ka zgjatur edhe dy javë (14 ditë). Në emër të frikës së pësuar, për paditësin gjykata ka caktuar shpërblimin në shumën prej 1.000.00 euro, dhe e ka vlerësuar si shpërblim të drejtë, duke u nisur nga fakti se sipas mendimit të ekspertit mjekësor të psikiatrisë, paditësi ka pësuar frikë primare prej disa sekondash, e cila është përcjellë me ndjenjën se ka përfunduar gjithçka dhe ky është fundi i jetës së tij, pastaj frikë sekondare të intensitetit të lartë që ka zgjatur rreth dy orë, deri në

marrjen e ndihmës së parë, e cila është manifestuar në formë të konfuzionit dhe brengës për paraqitjen e pasojave dhe frikë sekondare të intensitetit të mesëm që ka zgjatur rreth dy muaj, e cila është manifestuar me ankth, pagjumësi, dridhje të trupit, nervozë dhe me pasiguri për shkak të lëvizjeve të kufizuara për shkak të dhimbjeve të përjetuara në regjionin e qafës, shpinës dhe duarve.

Në emër të ndihmës dhe kujdesit të huaj, gjykata ka caktuar shpërblimin në shumë prej 140.00 euro, duke u nisur nga fakti se nga ekspertiza konstatohet se paditësi, ka pasur nevojë për ndihmë dhe kujdes të huaj në kohëzgjatje prej dy javësh (14 ditë), e cila ka qenë e nevojshme për plotësimin e nevojave si: ushqimi, veshmbathja, higjiena personale dhe aktivitete të tjera ditore.

Në emër të ushqimit të përforcuar, gjykata ka caktuar shpërblimin në shumë prej 140.00 €, duke u nisur nga fakti se nga ekspertiza konstatohet se paditësi, ka pasur nevojë për dy javë (14 ditë) për ushqim të pasuruar me proteina, minerale, vitamina më shumë se ushqimi i zakonshëm.

Ekspertizën e lartpërmendur gjykata e mori në tërësi të bazuar dhe ia dha besimin e plotë, këtë nga se ekspertiza përmban elementet e nevojshme të dhëna mbi bazën e njohurive profesionale dhe arsye të mjaftueshme të cilat gjykata i vlerësoi si të drejta për vërtetimin e fakteve vendimtare në këtë çështje kontestimore.

Mbi bazën e kësaj gjendje faktike gjykata vlerësoi se e paditura mbanë përgjegjësi në bazë të fajit për dëmin që i është shkaktuar paditësit me rastin e lëndimit gjatë aksidentit të trafikut, për çka e paditura është e obliguar që paditësit t'ia kompensoj dëmin me që shkaktuesi i dëmit kishte mbulesë siguroese nga e paditura dhe në këto rrethana, kompensimin e dëmit e bën e paditura mbi bazën e sigurimit të detyrueshëm nga autopërgjësia, konform Ligjit 04/L-018 për Sigurimin e Detyrueshëm nga Autopërgjësia dhe nenit 136 lidhur me nenin 918 të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve.

Gjykata gjeti se në rastin konkret, themelësia e pjesshme e kërkesëpadisë së paditësit, përveç bazës faktike, buron edhe nga baza juridike përkatësisht faktet e provuara në tërësi subsumohen në normën materialo-juridike nga e cila edhe del pasoja e caktuar juridiko-civile.

Përkatësisht sa i përket kompensimit të dëmit material, gjykata u bazua në nenin 179 par.1 të Ligjit Nr. 04/L-077 për Marrëdhëniet e Detyrimeve, ku përcaktohet se *Kush i shkakton tjetrit lëndim trupor ose ia dëmton shëndetin ka për detyrë të shpërblejë shpenzimet rreth mjekimit dhe shpenzimet tjera të nevojshme lidhur me këtë, si dhe fitimin e humbur për shkak të paaftësisë për*

*punë gjatë kohës së mjekimit. Ndërsa sa i përket dëmit jo material, gjykata u bazua në nenin 183 par.1 të Ligjit të lartcekur, ku përcaktohet se *Për dhembjet e pësuarat fizike, për dhembjet e pësuarat shpirtërore për shkak të zvogëlimit të aktivitetit jetësor, të shëmtimit, të cenimit të autoritetit, të nderit, të lirive ose të të drejtave të personalitetit, të vdekjes së personit të afërm, si dhe frikës, gjykata, po të konstatojë se rrethanat e rastit sidomos intensiteti i dhembjeve dhe i frikës dhe zgjatja e tyre e arsyetojnë këtë, do të gjykojë shpërblimin e drejtë në të holla, pavarësisht nga shpërblimi i dëmit material si dhe nga mungesa e dëmit material. Andaj, gjykata bazuar në këto dispozita ligjore vendosi për kompensimin e dëmit material dhe jo material si në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi.**

Duke u bazuar në dispozitat e cekura më lartë si dhe duke i vlerësuar të gjitha kriteret dhe masat për caktimin e lartësisë së shpërblimit të dëmit material dhe jo material, e posaçërisht duke marrë parasysh natyrën dhe shkallën e lëndimeve trupore të shkaktuara paditësit, në bazë të vlerësimit të ekspertizave mjekësore të përshkruar si më lartë, gjykata miratoj kërkesëpadinë e paditësve në vlerat e shpërblimit të dëmit si në pikën II të dispozitivit të aktgjykimit, duke vlerësuar si shpërblim real, objektiv dhe me bindje se ky shpërblim është në pajtueshmëri me natyrën dhe pasojat e lëndimit.

Gjykata konsideron se shumata e gjykuara si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, paraqesin një satisfaksion moral dhe shpëtim real për format e dëmeve të pësuarat të paditësit në aksidentin e komunikacionit, lëndimit dhe pasojave duke marrë parasysh edhe kriteret e parapara me dispozitën e nenit 183 të Ligjit mbi Marrëdhëniet Detyrimeve, standardin jetësor të qytetareve të Kosovës dhe Udhëzuesit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Nr.41/2023 të datës 27.02.2023, për Caktimin e Krieteve Orientuese dhe Lartësisë së Shpërblimit të Drejtë në të Holla të Dëmit jo material.

Gjykata vendosi si në pikën IV të dispozitivit të këtij aktgjykimi, duke refuzuar pjesën tjetër të kërkesëpadisë së paditësit në shumën prej 3,050.00 € (tremijë e pesëdhjetë euro), pasi që vlerësoi se kompensimi përtej shumës së aprovuar si në pikën II, nuk do të ishte në harmoni me të mirën e shkelur dhe me qëllimin që kompensimi të ishte i drejtë, ndërsa gjykata refuzoi kërkesën e paditësit, për kompensimin e dëmit material-rehabilitim fizio-terapeutik në shumën prej 154.00 € (njëqind e pesëdhjetë e katër euro), pasi që nga ana e palës paditëse, gjykatës nuk i është ofruar asnjë provë, me të cilën kishte me u vërtetuar lartësia e këtyre kërkesave të pretenduara. Andaj në mungesë të dëshmive për dëmin material gjykata vendosi si në dispozitiv të aktgjykimit për pjesën e refuzuar.

Gjykata lidhur me kërkesën për kamatën ka vendosur në mbështetje të nenit 382 të LMD-së dhe Mendimit Juridik për Kamatën të Gjykatës Supreme të Kosovës, Nr.265/2020 të datës 02.12.2020.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës si në pikën III të dispozitivit të këtij aktgjykimi, u bazua në dispozitat e neneve 449 dhe 452 par.3 të LPK-së, duke ia njohur paditësit shpenzimet e procedurës dhe atë në emër të përpilimit të padisë, shumën prej 104.00 euro, në emër të taksës gjyqësore shumën prej 40.00 euro, në emër të përfaqësimit për dy seanca gjyqësore shumën prej 270.00 euro dhe në emër të përpilimit të ekspertizës mjekësore shumën prej 300.00 euro, gjithsejtë shumën prej 714.00 euro.

Gjykata nuk ia njohu paditësit shpenzimin për precizimin e padisë në shumën prej 104.00 euro, ngase procedura kontestimore duhet të përfundohet me sa më pak shpenzime, e që kjo përcaktohet në parimin bazë të kësaj procedure, parimin e ekonomizimit të procedurës, si dhe precizimi i kërkesëpadisë nuk ka qenë i domosdoshëm të bëhet me shkrim por se i njëjti ka mundur të bëhet gjatë shqyrtimit kryesor pa u shkaktuar ky shpenzim shtesë, e krejt kjo bazuar edhe në nenin 453 par.1 të LPK-së, ku përcaktohet se *“Me rastin e vendosjes se cilat shpenzime do t’i shpërblehen palës, gjykata do të marrë parasysh vetëm ato shpenzime që kanë qenë të nevojshme për ndjekjen e çështjes në gjyq. Se cilat shpenzime kanë qenë të nevojshme, si dhe mbi shumën e shpenzimeve, vendos gjykata duke çmuar me kujdes të gjitha rrethanat”*.

Gjykata ka marrë parasysh pretendimin e palës së paditur, që paditësit ti njihen shpenzimet e procedurës varësisht nga sukcesi në procedurë, mirëpo ashtu siç është përcaktuar me Aktgjykimin e Gjykatës Supreme Rev.nr.252/2020, pasi për pjesën e refuzuar të kërkesëpadisë nuk janë krijuar shpenzime të veçanta, gjykata vendosi si në pikën III të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Andaj, bazuar në të lartcekurat e në lidhje me nenin 143 të LPK-së, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË-DEGA NË VUSHTRRI

Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil

C. nr. 535/19, me datë 20.12.2024

Gjyqtari
Jeton Zymeri

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar Ankesa në afat prej 15 ditësh nga marrja e të njëjtit, përmes kësaj gjykate për Gjykatën e Apelit në Prishtinë